

24 shkurt 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të datës 30.08.2023, si dhe sipas Informatorit Nr.20/2025-26 të Komisionit të Garave për inicimin e procedurës disiplinore, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), me datë 24.02.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. SHQIPTOHET masa disiplinore “Ndalesë kryerje të detyrës për periudhë prej nëntë (9) muaj” ndaj anëtarit të Bordit të KB Vëllaznimi, z. Jeton Bakalli, për shkelje disiplinore sipas Nenit 48(1)(f);
- II. Masa disiplinore e përcaktuar në pikën I të këtij vendimi nënkupton ndalimin e ushtrimit të çdo funksioni zyrtar nga z. Jeton Bakalli, në cilësinë e anëtarit të Bordit të KB Vëllaznimi, në të gjitha ndeshjet dhe aktivitetet e organizuara nga FBK, përfshirë por pa u kufizuar në përfaqësimin e klubit, komunikimin me zyrtarë të garës dhe ushtrimin e çdo kompetence që buron nga funksioni i tij;
- III. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Më datë 18.02.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), përmes postës elektronike, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore përmes Informatorit Nr. 20/2025-26 të Komisionit të Garave (tash e tutje “Kërkesa”), e cila ka të bëjë me supozimin për shkelje lidhur me garat, dhunën dhe dukuritë tjera negative në sport nga anëtari i Bordit të KB Vëllaznimi, z. Jeton Bakalli, në ndeshjen e zhvilluar me datë 14 shkurt 2026, me fillim nga ora 17:00, në Palestrën Sportive “Shani Nushi” në Gjakovë, ndërmjet KB Vëllaznimi dhe KB Sigal Prishtina.

Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, KD, më qëllim që menjëherë të filloj me shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore, me datën 19.02.2026, në orën 17:00, ka mbajtur takimin e parë shqyrtues, me ç ‘rast ka dizajnuar administrimin e procesit për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit. Në kuadër të këtij takimi, KD, në përbërje të plotë dhe aprovim të të gjithë anëtarëve vendosi që për qëllime të verifikimit të fakteve dhe në zbatim të drejtë të Rregullores Disiplinore të FBK-së, duke zbatuar nenin 38 të Rregullores

Disiplinore, nëpërmjet administratës së FBK-së, t'i kërkohet deklaratë me shkrim palës ndaj të cilit është iniciuar procedura.

Më datën 23.02.2026, KD, nëpërmjet email-it, sipas kërkesës, ka pranuar deklaratën me shkrim nga z. Jeton Bakalli.

Në funksion të trajtimit të lëndës, përveç takimit të datës 19.02.2026, KD ka mbajtur takim edhe me datë 23.02.2026, ku ka shqyrtuar deklaratën me shkrim nga z. Bakalli dhe provat e tjera të administruara nga sekretaria, përfshirë raportin nga ndeshja në fjalë dhe video-incizimin. Gjatë shqyrtimit, KD ka analizuar të gjitha dokumentet dhe provat në dispozicion, bazën ligjore, si dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, dhe ka konstatuar si në dispozitiv për arsyet e mëposhtme.

KD potencon se dispozita përkatëse që trajton këtë rast është Neni 48, alineja 1, pika f) i Rregullores Disiplinore i cili thotë:

1. Shkelje të rënda në lidhje me garat, dhunën dhe dukuritë e tjera negative në sport konsiderohen këto si në vijim:

[...]

(f) Sulmi fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive, qofshin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të ngjarjes sportive apo shikues, ose përleshja fizike mes pjesëmarrësve apo shikuesve – tifozëve.

Në rastin konkret, KD ka konstatuar, bazuar në video-incizimet e ndeshjes dhe dokumentacionin e administruar, se gjatë zhvillimit të ndeshjes së datës 14.02.2026 ka ndodhur sulm fizik ndaj gjyqtarit të ndeshjes nga ana e z. Jeton Bakalli, anëtar i Bordit të KB Vëllaznimi. Ky veprim përmbush në mënyrë të plotë elementet përbërëse të shkeljes së përcaktuar në Nenin 48, paragrafi 1, pika (f) të Rregullores Disiplinore, i cili sanksionon sulmin fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive.

Nga provat e administruara rezulton qartë se kontakti fizik ka qenë i drejtuar ndaj personit zyrtar të ndeshjes, në kundërshtim flagrant me parimet themelore të integritetit, respektit dhe sigurisë në garat sportive.

Sipas Nenit 49(1) të Rregullores Disiplinore të FBK-së, për shkeljen e përcaktuar në Nenin 48(1)(f), mund të shqiptohet masa disiplinore “Ndalesë loje apo kryerje të detyrës për periudhë të caktuar nga gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet”.

Në përcaktimin e lartësisë së dënimit konkret, KD është i obliguar që, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe individualizimit të dënimit, të vendosë brenda kufijve minimal dhe maksimal të paraparë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat ndikuese të rastit.

Në këtë drejtim, KD ka vlerësuar rrethanat e parapara me nenin 23 të Rregullores Disiplinore:

1.1. Pesha e shkeljes dhe pasojat

Sulmi fizik ndaj një gjyqtari përbën një nga shkeljet më serioze në kuadër të garave sportive, pasi cenon drejtpërdrejt autoritetin e zyrtarëve të ndeshjes dhe sigurinë në sport. Megjithatë, nga provat e administruara nuk rezulton të ketë pasur lëndime trupore apo pasoja fizike të rënda për gjyqtarin.

1.2. Shkalla e përgjegjësisë së kryerësit

Z. Bakalli, në cilësinë e anëtarit të Bordit të klubit, është person zyrtar me përgjegjësi të shtuar për promovimin e sjelljes korrekte dhe respektimin e rregullave të garës. Si zyrtar i klubit, ai ka detyrim të veprjë si shembull për sportistët, stafin dhe tifozët.

1.3. Nxitjet e brendshme

Nga shqyrtimi i rastit nuk është konstatuar ekzistenca e ndonjë motivi të planifikuar apo nxitjeje të paramenduar. Veprimi nuk rezulton të ketë qenë i organizuar apo i parapërgatitur.

1.4. Rrethanat në të cilat është kryer shkelja

Ngjarja ka ndodhur gjatë zhvillimit të ndeshjes, në një ambient me tension sportiv të lartë. Megjithatë, tensioni i ndeshjes nuk mund të shërbejë si justifikim për ushtrim të dhunës fizike ndaj zyrtarëve.

1.5. Qëllimi apo motivi i shprehur

Nga deklarata e z. Bakalli rezulton se veprimi është kryer në gjendje afekti, pa paramendim paraprak. KD e konsideron këtë si rrethanë lehtësuese, por jo përjashtuese të përgjegjësisë disiplinore.

1.6. Sjellja para dhe pas shkeljes

Z. Bakalli ka pranuar fajin në deklaratën e tij me shkrim dhe ka shprehur keqardhje, duke pranuar se veprimi i tij është i pajustificueshëm dhe në kundërshtim me vlerat e sportit.

1.7. Vetitë morale dhe kontributi në sport


KD ka marrë parasysh faktin se z. Bakalli është kontribuues i kahershëm në sportin e basketbollit dhe nuk rezulton të ketë pasur më parë masa disiplinore të natyrës së ngjashme.

Megjithatë, KD thekson se dhuna fizike ndaj gjyqtarëve dhe zyrtarëve të ndeshjes përbën cenim serioz të integritetit të garave dhe nuk mund të tolerohet, veçanërisht kur kryhet nga persona zyrtarë të klubeve, të cilët kanë përgjegjësi të shtuar për ruajtjen e rendit dhe respektimin e autoritetit sportiv.

Në balancimin e të gjitha rrethanave lehtësuese dhe rënduese, si dhe duke zbatuar parimin e proporcionalitetit, KD vlerëson se masa minimale prej gjashtë (6) muajsh do të ishte e pamjaftueshme për të reflektuar seriozitetin e shkeljes dhe nevojën për efekt parandalues, ndërsa masa maksimale do të ishte joproporcionale në raport me mungesën e pasojave trupore dhe pranimin e fajit.

Për rrjedhojë, KD ka vendosur që ndaj z. Jeton Bakalli të shqiptojë masën disiplinore “Ndalesë kryerje të detyrës për periudhë prej nëntë (9) muajsh”, duke e konsideruar këtë masë si të drejtë, proporcionale dhe të përshtatshme për të arritur qëllimin disiplinor – mbrojtjen e integritetit të garave, garantimin e sigurisë së pjesëmarrësve dhe dërgimin e një mesazhi të qartë se veprimet e dhunshme nuk tolerohen në sportin e basketbollit. Bazuar në të gjitha sa më sipër, KD vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor:



Afrim Kamishi
Anëtar



Omer Daku
Kryetar



Blerim Vuniqi
Anëtar

Prishtinë, 24 shkurt 2026

Vendimi i dërgohet:

- Jeton Bakalli
- KB Vëllaznimi
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor
- Shoqatës së Gjyqtarëve të Basketbollit të Kosovës
- Arkivit të FBK-së



Këshilla Juridike:

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën prej 300€, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.